

Lajme nga Bordi i Arsimit të Rajonit Shkollor të Filadelfias.

MIRË SE ERDHËT NË BULETININ TONË!

Numri 1: Vjeshtë 2021

Mirë se erdhët në botimin e parë të buletinit të ri tremujor të Bordit, ku mund të gjeni lajme të përditësuara nga Bordi, një përmbledhje të shkurtër të monitorimit të përparimit të synimeve dhe masave mbrojtëse si dhe shënime kalendarike.

Përpara se të vazhdoni të lexoni, desha të vë në dukje sfidat serioze me të cilat jemi përballur gjatë këtij viti shkollor me rritjen e dhunës me armë, transportin, pastrimin e plehrave dhe plotësimin me staf -- të gjitha këto ndërkohë që merremi me pandeminë e koronavirusit në vazhdimësi. Ju lutemi jini në dijeni se Rajoni Shkollor dhe Bordi i Shkollës kanë qenë duke punuar shumë që të gjejnë zgjidhje dhe që t'i mbajnë nxënësit dhe stafin tonë të shëndetshëm dhe të sigurt që kur filloi mësimi fizikisht. E vlerësojmë shumë durimin dhe përkushtimin tuaj ndaj arsimit publik gjatë kësaj kohe sfiduese.

Faleminderit për kohën që po kushtoni për të lexuar lajmet tona dhe për t'u lidhur me Bordin e Arsimit. Në qoftë se keni ndonjë koment ose pyetje, ju lutemi na dërgoni email te schoolboard@philasd.org.

Joyce S. Wilkerson, Presidente e Bordit

SYNIMET DHE MASAT MBROJTËSE

Bordi identifikon pika kyçe gjatë sesioneve të monitorimit të përparimit

Bordi ka identifikuar pika kyçe që kur filloi monitorimin e përparimit drejt synimeve dhe masave mbrojtëse, plani i Bordit për të rritur arritjet e nxënësve dhe për të krijuar kushte që nxisin mësim nga ana e nxënësit. Gjatë mbledhjeve mujore të veprimit, anëtarët e Bordit i kushtojnë kohë monitorimit të përparimit të një synimi apo mase mbrojtëse duke rishikuar të dhëna që tregojnë se sa në vijë është Rajoni Shkollor me përmbushjen e objektivave të planit. Ky rishikim i të dhënave është gjithashtu informativ për vendimmarrjen e anëtarëve të Bordit gjatë rishikimit të politikave, buxheteve dhe iniciativave të Rajonit Shkollor. Ju lutemi ejani dhe merrni pjesë në mbledhjen e ardhshme të veprimit më 28 tetor ku Bordi do të rishikojë përparimin drejt synimeve 4 dhe 5 të cilat përqendrohen në gatishmërinë për universitet dhe karrierë.

“Ka pasur disa pika të qarta që kanë dalë në dritë që kur filluam monitorimin e këtyre synimeve” - tha Presidentja e Bordit, Joyce Wilkerson. “Këto tendenca na kanë ndihmuar që të

identifikojmë nevojat e nxënësve tanë dhe pastaj të investojmë në burime dhe strategji të përqendruara, të cilat mund të shihen në buxhet.”

[MËSONI MË SHUMË](#)

PËRDITËSIME NGA BORDI

Bordi i Arsimit fillon kërkimet për një mbikëqyrës të ri

Në gusht 2022, pas 10 vjet shërbimi, William R. Hite, Jr., Ed.D., do të largohet nga roli i tij si Mbikëqyrës i Rajonit Shkollor të Filadelfias. Kërkimet për mbikëqyrësin e ardhshëm kanë filluar zyrtarisht dhe do të kryhen nga një ekip kërkimi profesional. Kërkimet do të fillojnë me 17 sesione dëgjimore, të mbajtura fizikisht dhe virtualisht gjatë një periudhe prej 18 ditësh, duke ftuar anëtarë të komunitetit që të japin mendimet e tyre për karakteristikat që ata duan të shikojnë në një mbikëqyrës të ri. “Mendimet e komunitetit do të jenë kritike për Bordin gjatë identifikimit të cilësive dhe aftësive që nevojitet të ketë një mbikëqyrës dhe do të jenë informative për përshkrimin e punës së tij” - tha Presidentja e Bordit, Joyce Wilkerson. “Ne e dimë se komuniteti ka mendime të vlefshme dhe unike të cilat mund të na ndihmojnë që të identifikojmë se kush duhet të jetë mbikëqyrësi ynë i ardhshëm.”

Për informacionin më të fundit për këtë proces, ju lutemi vizitoni uebsajtin tonë duke klikuar në butonin poshtë “Mësoni më shumë”.

[MËSONI MË SHUMË](#)

Takohuni me përfaqësuesit e rinj të Bordit të Nxënësve!

Bordi i Arsimit i uroi mirëseardhjen dhe zyrtarisht “instaloi” Rebecca Allen dhe Armando Ortez si Përfaqësues të Bordit të Nxënësve për vitin shkollor 2021-2022 gjatë mbledhjes së tij të veprimt në qershor. Në këtë rol, Rebecca dhe Armando përfaqësojnë moshatarët e tyre duke ndarë shqetësimet e nxënësve me Bordin në mbledhjet e tij mujore dhe duke i raportuar të gjithë nxënësve diskutimet dhe veprimet e Bordit.

Rebecca, nxënëse e vitit të tretë në Shkollën e Mesme Central (Qendrore), dhe Armando, nxënës i vitit të katërt në Shkollën e Mesme Northeast (Verilindore), e filluan rolin e tyre në Bord me 19 gusht. Ata shpresojnë t’i japin zë shqetësimeve të nxënësve dhe të punojnë drejt shqyrtimit të këtyre çështjeve, duke pasur si synim përfundimtar përmirësimin e përvojës në shkollë për të gjithë nxënësit e Rajonit Shkollor.

[MËSONI MË SHUMË](#)

LAJME NGA KËSHILLI KËSHILLIMOR I PRINDËRVE DHE KOMUNITETIT

Bordi i uron mirëseardhjen anëtarëve të rinj të Këshillit Këshillimor të Prindërve dhe Komunitetit

Në mbledhjen e tij të veprimit në gusht, Bordi i Arsimit i uroi mirëseardhjen anëtarëve të rinj të Këshillit Këshillimor të Prindërve dhe Komunitetit (PCAC) të cilët do të shërbejnë me një mandat prej dy vjetësh i cili filloi në gusht. Anëtarët e rinj janë: Jameika Id-Deen, Walette Carter, Tierra Rich, Horace Clouden, Quibila Divine, Jennifer Fisher, Georgia Kiowski, Michael Gorman, Orien Smith Warren, Crystal Green Porter, Najmah Ryan, Tracy Joslyn, Evelyn Reed dhe Marilyn Rodriguez. E nderuara Chandra Williams ka filluar një mandat të dytë ndërsa Christiana Uy dhe Elyse Castillo po përfundojnë mandatin e tyre të parë.

PCAC-ja shërben si urë midis komuniteteve shkollore të qytetit dhe Bordit ku anëtarët e këshillit ndajnë informacion kritik për punën e Bordit nëpërmjet rrjeteve të tyre ndërsa i komunikojnë Bordit shqetësimet e komuniteteve të tyre shkollore.

[MËSONI MË SHUMË](#)

MBLEDHJET E VEPRIMIT

Përditësim për formën e mbledhjeve tona të veprimit

Bordi tani po mban mbledhje veprimi në formë hibrid ku shumica e anëtarëve të Bordit marrin pjesë në mbledhje fizikisht së bashku me folës të regjistruar të cilët mund të zgjedhin që të flasin fizikisht ose në distancë. Kjo vjen pas mbajtjes së mbledhjeve në distancë për më shumë se një vit në përputhje me udhëzimet shëndetësore publike të Covid 19-ës.

Mbledhjet e ardhshme të Bordit

- 28 tetor 2021, 4 pasdite - mbledhje veprimi e Bordit
 - Sesion për monitorimin e përparimit për synimet 4 dhe 5 të cilat përqendrohen në gatishmërinë për universitet dhe karrierë
- 4 nëntor 2021, 4 pasdite - mbledhje e Komitetit të Politikave
- 18 nëntor 2021, 4 pasdite - mbledhje veprimi e Bordit
 - Sesion për monitorimin e përparimit për masën mbrojtëse 1: mirëseardhja dhe shkollat mbështetëse
- 9 dhjetor 2021, 4 pasdite - mbledhje veprimi e Bordit
 - Sesion për monitorimin e përparimit për masën mbrojtëse 2: përvoja shkollore pasuruese dhe të gjithanshme

- Sesion për monitorimin e përparimit për masën mbrojtëse 3: partneriteti me prindërit/pjesëtarët e familjes

Rreth Bordit të Arsimit

Bordi i Arsimit është organi qeverisës i përgjegjshëm për mbikëqyrjen e të gjitha politikave dhe vendimeve buxhetore të Rajonit Shkollor të Filadelfias. Përveç kësaj, Bordi i Arsimit shërben si autorizues për të gjitha shkollat statut (charter) në Filadelfia. Bordi përbëhet nga nëntë anëtarë të Bordit të cilët emërohen nga Kryetari i Bashkisë dhe konfirmohen nga Këshilli i Qytetit.

Anëtarët aktualë të Bordit janë: Joyce S. Wilkerson, Presidente; Leticia Egea-Hinton, Zëvendës Presidente; Julia Danzy, Mallory Fix-Lopez, Maria McColgan, Lisa Salley, Reginald Streater dhe Cecelia Thompson.

Faleminderit që lexuat buletinin tonë!